



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.6.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PEJËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Pejës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Astrit Bllaca, i mbështetur nga Fikret Ibrahim (udhëheqës i ekipit) dhe Senver Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	29
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	33


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Pejës për vitin 2015 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 09.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


“Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes” sepse auditimi ynë ka identifikuar keqklasifikime në llogaritë e PVF-ve në vlerën totale prej 308,255€ si dhe vlera e pasurive të pa regjistruara në SIMFK ishte 3,981,660€.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga komuna, funksionon në mënyrë efektive në disa fusha, por dobësitë ende janë të pranishme në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E PEJËS

OPINION I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj te fakti se:

Komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve në vlerë totale 308,255€, ku përfshihen: pagesat për mirëmbajtje e rrugëve 197,652€, mirëmbajtje e ndriçimit publik 7,760€, zbukurimi i qytetit për festa 9,995€, mirëmbajtje e objekteve shkollore dhe shëndetësore 21,211€, studimi i fizibilitetit për terrenet e skijimit 32,500€, përkrahje e ndërmarrjeve 9,324€, rrënimi i objekteve 4,400€ dhe shpenzime tjera të identifikuar në vlerë prej 25,413€ të cilat janë paguar nga buxheti i Investimeve Kapitale. Këto shpenzime duhej trajtuar si shpenzime për mallra dhe shërbime dhe subvencione. Arsyeja kryesore për këtë gabim është buxheti i kufizuar për mallra dhe shërbime, nga të cilat komuna nuk mundet t'i mbulojë këto shpenzime.

Vlen të sqarohet se shuma prej 308,255€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Pasuritë e përfituara gjatë vitit 2015, në pronësi të komunës me vlerë mbi 1,000€, nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin kontabël të pasurive. Vlera e deklaruar nga komuna, e paregjistruar në SIMFK ishte 3,981,660€.

Te hyrat nga tatimi në pronë sipas sistemit në Ministrinë e Financave janë më të larta se ato të regjistruara në SIMFK për shumën prej 28,726€. Deri në fund të auditimit, përpjekjet për harmonizimin e diferencave në mes të komunës dhe Ministrisë së Financave nuk kanë rezultuar me sqarimet e kërkuara. Për çështjet e theksuara më lartë, ne nuk e kemi kualifikuar opinionin.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Kryetari i Komunës dhe Zyrtaari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtaari Kryesor Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe

ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 09.10.2015, janë identifikuar katër (4) rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Dy prej tyre që kanë të bëjnë me klasifikimin e shpenzimeve dhe vlerësimin e pasurisë janë materializuar sepse nga menaxhmenti nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për t'i adresuar këto rreziqe.

Keqklasifikimet e identifikuar në vlerë totale prej 308,255€, janë pagesat për mirëmbajtje e rrugëve 197,652€, mirëmbajtje e ndriçimit publik 7,760€, zbukurimi i qytetit për festa 9,995€, mirëmbajtje e objekteve shkollore dhe shëndetësore 21,211€, studimi i fizibilitetit për terrenet e skijimit 32,500€, përkrahje e ndërmarrjeve 9,324€, rrënimi i objekteve 4,400€ dhe shpenzime tjera të identifikuar në vlerë prej 25,413€ të cilat janë paguar nga buxheti i investimeve kapitale. Këto shpenzime duhej trajtuar si shpenzime për mallra dhe shërbime dhe subvencione.

Pasuritë e përfituara gjatë vitit 2015, në pronësi të komunës me vlerë mbi 1,000€, nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin kontabël të pasurive. Vlera e deklaruar nga komuna, e paregjistruar në SIMFK ishte 3,981,660€.

Rreziku tjetër për pagesat nga palët e treta nuk është materializuar, se menaxhmenti ka marrë veprimet e duhura për regjistrimin e tyre në SIMFK në vlerë 329,198€, dhe janë paraqitur në PVF.

Rreziku i katërt domethënës që ka të bëjë me prezantimin e të hyrave nuk është materializuar sepse menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e duhura gjatë vitit 2015.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me kornizën raportuese, me përjashtim të çështjes se ZKF nuk ka raportuar për progresin fizik dhe financiar të investimeve kapitale.

DEKLARATA E BËRË NGA KRYETARI I KOMUNËS

Marrë parasysh çfarë u tha më lartë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, nuk mund të konsiderohet plotësisht e saktë, për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale, dhe për të siguruar regjistrimin dhe vlerësimin e saktë të pasurive kapitale.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se ZKF raporton në mënyrë sistematike mbi progresin e fizik dhe financiar të investimeve kapitale. Aty ku është e nevojshme, duhet të azhurnohen projektet në programin e investimeve kapitale, në mënyrë që kërkesat e ardhshme buxhetore të jenë bërë në bazë të nevojave reale për investime.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo reflekton përkushtimin e menaxhmentit për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të mbështeten nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes në komunë, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut, zbatimin e objektivave strategjike dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit duhet të merren parasysh.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të komunës ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, një (1) rekomandim është implementuar, tetë (8) janë në proces adresimit dhe gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Raporti i auditimit të vitit 2014, ishte diskutuar edhe në Asamblenë Komunale.

Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një rekomandim i vitit të kaluar ishte implementuar, sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Rreziku Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar në:

- Planifikim dhe ekzekutim të dobët të buxhetit;
- Mungesë e raporteve kthyesë lidhur me subvencionet e shpërndara;
- Mbi/nën vlerësim të shpalosjeve në pasqyra; dhe
- Dobësi në qeverisjen e përgjithshme.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsyet pse i njëjti nuk është zbatuar. Një plan i rishikuar duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri nga ana e komunës, dhe kemi vlerësuar disa pyetje kyçe për komponentët e listës kontrolluese. Gjetjet tona i kemi përmbledhur më poshtë. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por pasqyron gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna ka hartuar Planin Zhvillimor Strategjik. Në këtë dokument strategjik nuk janë të përcaktuara në tërësi kostot financiare për zbatimin e objektivave.
3. Gjithashtu, nuk janë hartuar plane të qarta veprimi për adresimin e rekomandimeve ku do të përcaktoheshin afatet dhe personat përgjegjës për adresimin e rekomandimeve. Kjo është vërtetuar edhe me përgjigje negative në pyetësorin e vetëvlerësimit/rjedhimisht me notë të ulët;
4. Në vitin e kaluar ne kemi dhënë rekomandim për planifikim më cilësor sa i përket llojeve të prokurimit, në mënyrë që të shmangen ndarjet e tenderëve. Tashmë është vendosur një lidhje në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit; dhe
5. Udhëheqësit e njësive përgatisin raportet tre mujore për Kryetarin dhe Kuvendin Komunal. Takimet mbahen në baza të rregullta, por nuk ka dëshmi në dispozicion për të konfirmuar se në këto takime përcaktohen formalisht hapat për të adresuar çështjet e ngritura;

Auditimi i Brendshëm nuk i ka adresuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka rikonfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla, nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Dobësi në Kontrollat Menaxheriale – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Raportimet ndaj menaxhmentit të lartë nuk ishin të formalizuara dhe dokumentuara në mënyrë të kënaqshme. Kjo është edhe arsyeja pse ne nuk jemi mbështetur në kontrollet në nivele të larta të menaxhmentit, sepse nuk ishim në gjendje të verifikonim nga procesverbalet e takimeve të kryetarit, masat e ndërmarra dhe diskutimet e bëra.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, rezultojnë në kontrolle të dobëta, dobësi në procesin buxhetor, reduktojnë mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë, si dhe potencialisht rezultojnë me humbje financiare.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi drejtoritë e komunës dhe të implementojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuar dhe për të përmirësuar qeverisjen e mirë në të gjithë komunën.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy auditor, ndërsa Drejtori i NJAB është i suspenduar nga puna. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Plani vjetor i punës së NJAB për vitin 2015 ishte hartuar bazuar në planin strategjik 2014-2016. NJAB ka planifikuar gjatë vitit 2015 të kryej 12 auditime dhe nuk ka pasur devijime nga ky plan. Të gjitha auditimet janë përfunduar me kohë dhe gjatë kësaj faze ishin mbuluar disa nga fushat kryesore. Menaxhmenti i komunës zbaton proces formal të përcjelljes së adresimit të rekomandimeve.

Çështja 5 – Mos implementimi i rekomandimeve të NJAB – Prioritet i lartë

E gjetura	Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB: <ol style="list-style-type: none">1. Puna e NJAB ishte fokusuar më shumë në auditimin e aktiviteteve të vitit 2014 sesa aktivitetet aktuale të vitit 2015;2. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur vetëm një takim gjatë vitit 2015. Në procesverbalin e takimit të komitetit të auditimit vërehet se nuk është diskutuar edhe për rekomandimet e auditorit të jashtëm, por njëkohësisht nuk ka pasur përpjekje për fuqizimin e punës së NJAB në përgjithësi; dhe3. Gjatë vitit 2015, NJAB ka dhënë gjithsej 50 rekomandime prej të cilave 30 janë adresuar plotësisht, 9 janë adresuar pjesërisht, derisa 11 nuk janë zbatuar apo ende kërkojnë kohë për tu adresuar.
Rreziku	Fokusimi i punës së NJAB në vitet e kaluara rritë rrezikun që menaxhmenti të mos ketë vlerësimet e duhura për efektivitetin e kontroleve aktuale dhe të mos jetë në gjendje të reagoj me kohë ndaj dobësive ekzistuese. Mungesa e një komiteti funksional të auditimit rritë rrezikun që rekomandimet e auditimit të mos implementohen, dhe që cilësia e punës së auditimit të brendshëm të mos arrij rezultatet e pritura.
Rekomandimi 7	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe të propozoj masa të menjëhershme përmirësimi. Gjithashtu, komiteti i auditimit duhet të jetë shumë më aktiv në mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë e një sistemi adekuat dhe të fortë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës (procedura standarde të operimit) të cilat sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve vendore, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	21,125,279	23,098,544	21,146,160	20,536,683	20,263,382
Granti i Qeverisë-Buxheti	17,730,728	18,048,803	17,984,147	17,232,343	16,980,919
Të bartura nga viti paraprak ²	-	711,878	648,492	659,067	650,615
Të hyrat vetjake ³	3,394,551	3,394,551	2,217,268	2,566,106	2,456,879
Donacionet e brendshme	-	452,647	50,640	0	4,500
Donacionet e jashtme	-	490,665	245,613	79,167	170,469

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,973,266€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 318,075€ (për kompensimin e përvojës së punës), donacioneve të brendshme për 452,647€, donacioneve të jashtme për 490,665€ si dhe të hyrat të bartura në vlerë 711,877€.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2015, janë shpenzuar 92% të buxhet final me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit për kategori mbetet në nivel jo të kënaqshëm, dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale. Pasqyra e mëposhtme dhe përqindjet e kalkuluara janë prezantuar pa konsideruar keqklasifikimet e identifikuar të paraqitura tek rreziku domethënës.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	21,125,279	23,098,544	21,146,160	20,536,683	20,263,384
Pagat dhe Mëditjet	12,670,000	13,034,542	13,002,566	11,925,237	10,482,665
Mallrat dhe Shërbimet	2,291,461	2,435,586	2,262,418	2,260,801	2,705,611
Shërbimet komunale	606,919	606,944	606,154	528,460	597,009
Subvencionet dhe Transferet	365,000	366,840	359,212	428,300	599,233
Investimet Kapitale	5,191,898	6,654,632	4,915,810	5,393,855	5,878,865

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Planet buxhetore për investime kapitale në Komunën e Pejës për vitin 2015 ishin 6,654,632€, prej të cilave janë realizuar 4,915,810€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale gjatë vitit, vetëm 74% e buxhetit ishte shpenzuar. Buxheti i planifikuar në investime kapitale prej të hyrave vetjake dhe donacionit të brendshëm kishte mbetur i pa shpenzuar.
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 318,075€, është rezultat vendimit të Qeverisë për mbulimin e 0.5% të përvojës së punës. Ndërsa rritja në kategorinë mallra dhe shërbime ishte kryesisht nga të hyrat e bartura dhe donacionet.
- Po ashtu, buxheti i komunës ishte shpenzuar edhe përmes vendimeve gjyqësore dhe pagesave direkte nga Thesari në vlerë prej 517,804€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - pranimi krahas buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,394,550	3,394,550	3,337,518	3,271,418	3,003,047

Të hyrat e planifikuara gjatë vitit 2015 ishin realizuar 98%. Të hyrat vetjake, të barturat dhe inkasimi i vitit nuk ishin shpenzuar në tërësi në dobi të qytetarëve, por kishin mbetur të pashpenzuara 1,183,637€.

Çështja 6 - Realizimi i dobët i buxhetit për projekte kapitale - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Të hyrat vetjake preferohet të shpenzohen në projekte kapitale. Komuna, 26% të planit nga të hyrat, kishte planifikuar t'i shpenzojë për investime kapitale, ndërkohë që kishte arritur t'i shpenzojë vetëm 15%. Ndërsa është shpenzuar një normë relativisht të lartë, 44% për shpenzime operative, si: kujdestaritë dhe shtesat, mallra shërbime dhe subvencione e transfere.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ultë i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm. Gjithashtu, koncentrimi i të hyrave në financimin e shpenzimeve operative dhe mos shpenzimi i të hyrave redukton aftësinë e komunës në përmirësim të shërbimeve për qytetarë.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku mund të bëhen përshtatjet për reduktim të shpenzimeve operative, të njëjtat të rishikohen për koncentrim në projekte kapitale.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Gjatë vitit 2015 në total janë zbatuar 124 procedura të prokurimit në vlerë prej 4,614,552€.

Çështja 7 - Tejkallim i pozicioneve dhe furnizim jashtë kontratës - Prioritet i lartë

- E gjetura** Pozicionet e paguara për ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat e Lugut të Baranit, ishin më të larta se pozicionet e kontraktuara në vlerë prej 52,338€, pa aprovim përkatës apo kontratë shtesë. Komuna kishte paguar edhe për 5 pozicione shtesë për ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat e Lugut të Baranit në vlerë prej 119,980€ të cilat nuk ishin të kontraktuara. Vlera totale e këtyre pagesave ishte 172,318€. Ky projekt për ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat e Lugut të Baranit në vlerë 3,447,983€ ishte ndërprerë me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare edhe pse kontrata financiarisht ishte përmbushur 79% deri më tani apo 2,727,784€.

Rreziku Kontrolllet e aplikuara lidhur me zbatimin e kësaj kontrate janë të dobëta. Shuma e pagesave prej 172,318€ nuk është e bazuar në detyrimet e kontratës bazë, dhe si e tillë, përmban elemente të pagesave të parregullta. Kontrolllet e mbikëqyrjes së punimeve dhe certifikimit nuk ishin efektive, dhe për pasojë, nuk dihet kur projekti mund të përfundoj dhe cila do të jetë kosto përfundimtare e projektit. Nuk është e qartë nëse është arritur vlera për parane.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet t'i shqyrtoj arsyet pse dështimet lidhur me zbatimin e kontratës kanë ndodhur, dhe të propozoj hapat që duhet ndiqen deri në finalizimin e kësaj kontrate. Gjithashtu, kontrolllet e certifikimit duhet të forcohen dhe të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas konfirmimeve të pozicioneve të parapara në kontratë.

Çështja 8 - Furnizim selektiv me material administrativ - Prioriteti i lartë.

E gjetura Një kontratë kornizë për blerjen e materialit administrativ të zyrës ishte tejkualuar në disa pozicione, ndërsa disa artikuj nuk ishin furnizuar asnjëherë, edhe pse kontrata përfundon afatin tre vjeçar në 12.07.2016. Nga ekzaminimet tona ne kemi testuar 9 nga 220 pozicionet e kontraktuara dhe kemi gjetur se ishin furnizuar 11,000 rise me letër A4 si materiali më i shpeshtë administrativ nga 7,000 sa ishin kontraktuar. Në katër lloje të tonerëve me çmimin më të lartë ishte tejkualuar sasia e kontraktuar 520% për Toner LBP 600B me çmim 41€/copë, 124% për Toner 12A me çmim 33€/copë, 485% për Toner 35A me çmim 35€/copë dhe 280% për Toner 85A me çmim 4.10€/copë. Derisa, katër prej 48 lloje të tonerëve të kontraktuar me çmim prej 0.01€ nuk ishin furnizuar asnjëherë (TN 2 16Y; TN 2 16R; TN 2 16C dhe TN 2 16K). Komuna nuk ka qenë në gjendje të na dëshmoj nëse ka në përdorim aparate printimi për 48 lloje të Tonerëve.

Rreziku Tejkalmimi i disa furnizimeve të kontraktuara në sasi shumëfish më të larta se sasi të kontraktuara, dhe furnizimi i sasisë zero për materiale të tjera të kontraktuara, tregon dobësitë serioze në vlerësimin e nevojave dhe ngritë paqartësi për arsyeshmërinë e këtyre furnizimeve. Rrjedhimisht, buxheti i komunës potencialisht mund të jetë dëmtuar për shkak të dobësive në procesin e prokurimit.

Rekomandimi 10 Dobësitë e identifikuar më lartë lidhur me këto furnizime duhet të rishikohen dhe kryetari duhet të siguroj që me rastin e hartimit të planit vjetor të prokurimit, nga të gjitha njësitë kërkuese është bërë një vlerësim real i nevojave dhe që të gjitha kontratat të lidhen vetëm për materialet dhe sasinë e nevojshme.

Çështja 9 - Furnizime dhe shërbime pa kontratë/marrëveshje paraprake - Prioriteti i lartë

E gjetura Kontrata kornizë për furnizim me naftë kishte qenë valide deri më datë 11.02.2015, ndërsa nga kjo datë furnizimi bëhet në bazë të një zgjatje e kontratës nga drejtori i prokurimit, deri në një kontraktim të ri dhe vlera e paguar pas skadimit të kontratës është rreth 293,005€.

Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës në vlerë 2,842€, janë kryer në vitin 2014, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vitin 2015.

Kontrata për "Mirëmbajtja e kanaleve të hapura, pastrimi i tyre dhe heqja e mbeturinave të mbetura" në vlerë 9,833€ është nënshkruar me 24.06.2015, ndërsa pagesa është bërë për punët e kryera prej 10 deri më 30.06.2015.

Komuna, për udhëtime zyrtare jashtë vendit biletat e fluturimit i kishte blerë me para kesh në vend të blerjes përmes procedurave.

Tek kontrata "Kryerja e shërbimeve të fotokopjimit dhe printimit të materialeve administrative për nevojat e drejtorive së SHCK' janë përdorur procedura të kuotimit të çmimeve në vend të procedurave të hapura, siç kërkohet nga LPP. Në rastet e kontratave publike kornizë, autoriteti kontraktues duhet që të përdorë njëri nga procedurat: Hapur; Kufizuar; ose Procedurën e Negociuar

Rreziku Gjetjet e përmendura më sipër përshkruajnë dobësitë e shumta që kanë shoqëruar procesin e prokurimit. Këto mund të rezultojnë me rrezikun real që fondet publike të mos shfrytëzohen në mënyrë racionale dhe të mos jetë arritur vlera për parane.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet forcoj kontrollet e prokurimit dhe të sigurohet se proceset e prokurimit zhvillohen në pajtim të plotë me rregullat e përcaktuara ligjore dhe udhëzuesit përkatës. Rasti i vazhdimit të furnizimit me naftë pa kontratë të vlefshme, duhet të shqyrtohet, dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten.

Çështja 10 - Kostoja apo sasia në faturë nuk ishte në pajtim me çmimin e kontraktuar - Prioriteti i lartë

E gjetura Çmimi i blerjes së naftës me 'Premium' nuk ishte kalkuluar si duhet pasi që çmimi i transportit nuk ishte kalkuluar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. QRK 04/2014 për Përcaktimin e Shpenzimeve të Kostos së Transportit të Mallrave të Importuara.

Në katër raste ishin bërë pagesa pa ndonjë konfirmim nga ana e komunës se shërbimet janë pranuar. Këto pagesa janë bërë për shërbime të pastrimit të mbeturinave 5,950€, furnizime pastrimi 3,468€, shërbime postare 12,600€, dhe pastrimi i objekteve shkollore 251,752€.

Pagesa iu ishte bërë OE për shërbime të tërheqjes së 50 makinave brenda qytetit, nga EUROEXPORT deri te Shkolla Teknike, duke faturuar largësinë prej 30 Km për veturë. Largësia reale deri në këtë destinacion është rreth 4 Km për veturë nga e cila konkludojmë se obligimi për pagesë ishte 1300 Km nga 1.5€ për Km vërejmë se fatura e paguar është 1,950€ më shumë Nga 200 Km sa do duhej paguar.

Për blerjen e kamionit të zjarrfikësve, në bashkëfinancim me ambasadën e Japonisë në Vjenë, komuna kishte paguar pjesën e participimit prej 40,500€, pa TVSH duke mos konsideruar se komuna nuk është e liruar nga ky lloj i tatimit.

Gjatë implementimit të kontratës për furnizim me gjedhe mështjerra grvide (5-7 muaj), plani dinamik i liferimit nuk është respektuar dhe ka pasur vonesa të theksuara për të cilat komuna nuk ka ekzekutuar penale.

Gjatë testimit të pagesave se ne kemi hasur në 17 pagesa, ku urdhërblerja është bërë pas pranimit të faturës.

Rreziku Kontrolllet e çertifikimit në rastet e mësipërme kanë dështuar në parandalimin e parregullsive të identifikuara. Pagesa e faturave për sasi më të mëdha sesa punët e kryera apo furnizimet e pranuar, rritë rrezikun e pagesave fiktive dhe humbjeve financiare. Raportet e pasakta të pranimit të punëve apo furnizimeve nga komisionet e pranimit të punëve rrisin rrezikun që të pagesat të bëhen edhe për punët/furnizimet që nuk janë kryer.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj se kontrolllet e çertifikimit do të forcohen, dhe se pas konfirmimit se të gjitha furnizimet janë kryer përmes raporteve të qarta të pranimit dhe në pajtim me kushtet e kontratave, mund të procedohet me pagesa. Në të kundërtën, pagesat nuk duhet të çertifikohen.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë shpenzimet për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit. Ato kanë të bëjnë me komunalitet, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat me bashkëfinancim.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive. Shpenzimet në paga gjatë vitit 2015 ishin 13,002,566€ apo 99.9% e buxhetit të planifikuar.

Çështja 11 - Mangësi në rekrutimin e personelit arsimorë - Prioriteti i lartë

E gjetura

Mungesa e kontrolleve të brendshme ka rezultuar në mangësitë në vijim:

Transferim i nëpunësit civil në kategori të ndryshme funksionale, gradë dhe hap të pagës, respektivisht nga pozita Zyrtar i lartë juridik në DSHMC në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Administratën e QKMF.

Konkurset për personel arsimorë ishin hapur pa një kërkesë për arsimtarë nga shkolla përkatëse.

Nuk janë respektuar procedurat e konkursit për arsimtarë me rastin e rekrutimit të arsimtarëve, duke mos shpallur konkursin në gazeta publike.

Në disa raste ishin zhvilluar procedura të intervistimit të kandidatëve për punësim në arsim nga komisione jo të plota të testimit.

Kontrata e të punësuarës ishte nënshkruar në muajin maj 2015, për 8 muaj me vonesë, respektivisht nga nëntori 2014.

Punëtori i pranuar të kryej detyra të menaxherit të prokurimit me marrëveshje për shërbimet e veçanta është pranuar në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me AMKMK, në anën tjetër ka realizuar dy paga për një orar të plotë të punës në institucionet publike. Marrëveshja është e lidhur vetëm për 3 muaj, ndërsa vazhdon punën edhe pas skadimit të këtij afati.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve të brendshme në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve lidhur me personelin dhe kategorinë paga dhe mëditje shpie drejt rrezikut të kontestimit të pozitave të shpallura, dhe mund të shkaktojë humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 13 Kryetari të ndërmarr masa konkrete për të siguruar një raportim të rregullt të departamenteve dhe të siguroj raporte përmbledhëse nga departamenti i burimeve njerëzore dhe të siguroj një proces të rregullt lidhur me rekrutimin dhe menaxhimin e personelit në komunë.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Komuna gjatë vitit 2015 kishte subvencionuar entitete jo-publike dhe përfitues individual në vlerë prej 358,000€ nga 365,000€ sa kishte planifikuar buxhetin për këtë kategori apo 98% e buxhetit. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

Ne kemi testuar pesë mostra të cilat kanë treguar mangësitë si në vijim:

Çështja 12 - Kritere të mangëta të Rregullores dhe mungesë raportimi nga përfituesit e subvencioneve - Prioritet i lartë

E gjetura Rregullorja e brendshme e komunës për ndarje të subvencioneve nuk kishte të vendosura kritere të qarta për ndarjen apo refuzimin e subvencioneve.

Komuna i kishte ndarë KF "Besa" subvencione në vlerë 18,500€. Në kërkesën e klubit për këtë subvencion nuk ishte bashkangjitur ndonjë plan konkret se ku do të shpenzohen mjetet dhe cila pjesë e shpenzimeve të KF "Besa" do të mbulohet nga subvencioni.

Komuna i kishte ndarë për OJQ "Anibar" subvencione në vlerë 10,000€, për projektin për edicionin e gjashtë të shfaqjes së filmave të animuar në Pejë në vlerë prej 122,867€. Në kërkesën e OJQ "Anibar" për këtë subvencion nuk ishte bashkangjitur ndonjë plan konkret se ku do të shpenzohen mjetet dhe cila pjesë e shpenzimeve të edicionit të gjashtë të shfaqjes së filmave të animuar në Pejë do të mbulohet nga subvencioni.

Komuna kishte subvencionuar OJQ "Mehmet Shoshi" nga Peja në shumën 34,400€ për ngritjen e busteve të disa heronjve të Pejës, duke mos përcaktuar me kontratë afatet kohore të përfundimit të punëve dhe kriteret, apo një autoritet profesional për pranimin e cilësisë materiale dhe artistike të busteve.

Subvencionimi prej 4,500€, mjete shtesë për rregullimin e rrethojës metalike të varrezave në fshatin Jabllanicë e madhe kishte ndodhur ne vitin 2014, ndërsa aprovimi për këtë subvencion ishte në vitin 2015.

Jo të gjithë përfituesit kanë ofruar çertifikatë të regjistrimit të OJQ-së apo dëshmi tjetër që dëshmon qëllimin publik të subjektit përfitues të subvencioneve.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin dhe dhënien e subvencioneve rrisin rrezikun që fondet të mos shpenzohen në pajtim me qëllimet e dedikuara. Aprovimi/refuzimi i kërkesave për subvencione në mungesë të kriterëve të qarta për ndarjen e tyre, rritë rrezikun e subjektivizmit dhe transparencës në ndarjen e subvencioneve dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të vendosë kriterë të qarta lidhur me përfitimin/refuzimin e kërkesave për subvencione. Të sigurohet që me rastin e subvencioneve të lejuara të kërkohen që të përpilohen raporte përshkruese bashkangjitur me dëshmi dhe fatura për arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe të përcillen aktivitetet për të cilat është lejuar subvencioni.

3.6 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2015 ishin 3,337,518€, apo shprehur në përqindje rreth 98% e buxhetit të planifikuar. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative dhe të tjera. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave, me qëllim të rritjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve.

Çështja 13 - Planifikim jo i duhur dhe mos barazim i të hyrave - Prioritet i lartë

E gjetura Për vitin 2015, ngarkesa për tatimin në pronë ishte 1,826,986€, ndërsa janë inkasuar 1,374,377€ prej të cilave 56,442€, kishin qenë kamata dhe dënime si dhe 427,228€ pagesa të tatimit nga vitet paraprake. Komuna kishte planifikuar që të inkasohen 1,500,000€, që ishte në shpërputhje me ngarkesat për vitin 2015.

Te hyrat nga tatimi në pronë sipas sistemit në Ministrinë e Financave janë më të larta se ato të regjistruara në SIMFK për shumën prej 28,726€. Deri në fund të auditimit, përpjekjet për harmonizimin e diferencave në mes të komunës dhe Ministrisë së Financave nuk kanë rezultuar me sqarimet e kërkuara.

Planifikimi i të hyrave nga taksat për lejet e biznesit, shitjen e mallrave dhe shërbimeve, lejet e ndërtimit, dhe inspektimin është ambicioz dhe aspak në përputhje me kapacitetin inkasues. Po ashtu, komuna nuk ka regjistruar të qartë mbi objektet dhe pronat tjera të dhëna me qira.

Gjatë rishikimit të planit për tatimin në pronë, kemi identifikuar se nuk është përfshirë në plan verifikimi i 1/3 së territorit për rivlerësim të pronave, siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave të tatimit në pronë.

Rreziku Mos barazimi i totalit të të hyrave nga tatimi në pronë me totalin e paraqitur në PVF e rritë rrezikun që komuna të mos mund të kontrollojë në plotësi sistemin e të hyrave vetjake. Planifikimi pa mbështetje në analiza të trendeve dominuese, ekonomike si dhe potencialit në bazë të njësisë dhe popullatës, mund të rezultojë me një planifikim të dobët të buxhetit. Më tej, mos verifikimi i objekteve limiton marrjen e informacionit për bazën reale të ngarkesave me tatime dhe të shkaktoj humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 15 Kryetari të vendosë kontrole të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, barazimit dhe raportimit të të hyrave vetjake. Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzojë të gjitha burimet për verifikim të pronave.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Komuna e Pejës nuk kishte bërë përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive komunale sipas rekomandimit të dhënë vitin e kaluar. Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 1.3 Rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare.

Vlera neto e pasurisë së regjistruar në SIMFK në vitin 2015 ishte 309,863,016€, dhe është shpalosur në PVF.

Çështja 14 – Regjistra jo të plotë të pasurive komunale- Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë vitit 2015 në SIMFK, kishte regjistruar vetëm 17 zëra në vlerë prej 4,621€, ndërsa vlera e përgjithshme e Investimeve Kapitale gjatë vitit 2015 është 4,915,810€, çka do të thotë se ka pasuri të cilat nuk janë përfshirë në regjistër. Si shembull të investimeve që nuk janë regjistruar në SIMFK janë: investimet për ujësjellës në fshatin e Lugut të Baranit 1,577,711€ dhe bashkëfinancimi për restaurimin e qarshisë së vjetër 73,196€. Komisioni për inventarizimin e pasurisë ishte formuar, por i njëjti nuk e kishte përfunduar inventarizimin. Po ashtu regjistrimet në e-pasuri nuk ishin të plota.

Rreziku Regjistri jo i plotë i pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të formoj komisione për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.

3.7.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshme

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, të hyrat nga qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave të grumbulluara, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme. Megjithatë, vlen të theksohet se ligji për faljen e borxheve mund të ketë ndikuar në rënien e normës së inkasimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara.

Çështja 15 - Nën deklaram i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka të deklaruara shuma të konsiderueshme të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, taksa biznesi dhe qiraja, në vlerë 14,473,940€, që për dallim nga viti i mëhershëm 14,947,010€ ishin për 473,070€ më të ulëta.

Rreziku Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, mund të rezultojë me rritjen e këtyre llogarive, dhe rrjedhimisht edhe me efektin që burimet vetjake të financimit të mos planifikohen mirë. Pra, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmer veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.

3.7.3 Trajtimi i Llogarive të pagueshme

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 827,817€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Komuna nuk kishte një sistem të definuar për menaxhimin e Llogarive të pagueshme. Në anën tjetër, në fund të vitit 2015 komuna kishte 1,183,637€ të hyra vetjake të bartura në vitin 2016.

Çështja 16 - Mungesë e kontrolleve të mira për menaxhimin e obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Këtë vit, obligimet e pa paguara janë deklaruar në shumë 827,817€, që krahasuar me vitin paraprak ishin 609,000€ apo 26% më pak. Detyrimet kontingjente kanë arritur në 862,680€ nga 665,570€ sa ishin në vitin 2014, prej të cilave vetëm një detyrim ishte 390,000€, kompensim dëmi, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 472,680€ ishin për 18 subjekte tjera të natyrës kryesisht për kompensim dëmi apo borxhe të mbetura më herët.

Rreziku Mungesa e një disipline financiare për menaxhimin e këtyre llogarive paraqet edhe bazë çorientuese për buxhetim të aktiviteteve vijuese financiare. Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe rritja e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të rishikoj gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuara, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me avokatin komunal, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për t'iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF dhe gjykatat.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet , ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo të implementuar	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare	Plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë një rishikim kritik nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar kontrollet e nevojshme.		Pjesërisht Në PVF edhe këtë vit ka pasur gabime në zërat e paraqitur (shih pjesën 1.4)	Keqklasifikimet kanë ndodhur edhe në vitin 2015 dhe shpalesje të keq klasifikimeve nuk është bërë.
Keq klasifikimet	Keq klasifikimet të janë identifikuar dhe shpalesur para se të dorëzohen PVF në Qeveri. Një proces i mirëfilltë planifikimi dhe ekzekutimi buxhetor, do të ishte masë e nevojshme për eliminimin e dobësive të tilla.			
Rekomandimet e vitit paraprak	Plan veprimi i rishikuar, për adresim të rekomandimeve të pa-adresuara të vitit 2013, së bashku me rekomandimet e 2014, të përcaktojë një orar të qartë të zbatimit të tyre.			Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pa zbatuara.
Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet t'i rishikojë rregullimet qeverisëse aktuale dhe kërkesat e ndërlidhura për raportim të tyre. Kërkesat e pa plotësuara duhet të zbatohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia e çështjeve të ndërlidhura, siç është raportimi i brendshëm, duhet të rishikohen në mënyrë kritike për të dokumentuar që			Pjesa e menaxhimit të rrezikut nuk është adresuar. Komuna nuk ka vendosur linja formale të raportimit.

	<p>janë zbatuar veprime efektive për të siguruar menaxhim efektiv operacional të komunës dhe arritjen e objektivave strategjike.</p> <p>Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyeshmërinë e një numri kaq të lartë të kuotimeve, me theks të veçantë në rastet kur për shpenzime të njejta ekziston kontratë me procedurë të hapur. Kryetari duhet të forcojë kontrollet në planifikimin dhe realizimin e prokurimit duke siguruar që për shpenzimet e natyrës së njejtë do të përdoren procedurat e hapura për të arritur vlerën më të lartë për paranë e paguar.</p>		<p>Mungon një analizë lidhur me arsyen se pse një numër kaq të lartë të kuotimeve, por në vitin 2015 ka pasur numër ma të vogël të kuotimeve.</p>	
Buxheti	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë monitorimin e performancës buxhetore në mënyrë sistematike dhe në baza mujore për të siguruar nivel të pritur të ekzekutimit të buxhetit dhe përdorimin efektiv të të hyrave vetjake. Të gjitha shpenzimet duhet të planifikohen dhe klasifikohen në kodet/kategoritë e duhura dhe të shpalosen drejtë në PVF-të e vitit 2015.</p>		<p>Mungon një analizë e shkruar dhe në mënyrë sistematike por janë vërejtur përpjekje monitorimin e performancës buxhetore.</p>	
Të hyrat	<p>Kryetari i Komunës duhet të inicojë një analizë për arsyet e mospërputhjeve domethënëse në mes planifikimit, inkasimit dhe faturimit të të hyrave. Trendi i të hyrave gjatë viteve të kaluara duhet të merret në konsiderim, ndërsa aplikimi i kontrolleve të dobëta në aspektin e menaxhimit (bartja e të hyrave në vitin vijues) duhet të përmirësohet. Gjithashtu, kontrollet duhet të forcohen, për të siguruar që të gjitha institucionet e komunës do të inkasojnë të hyrat që parashihen me ligj dhe të njejtat do të raportohen dhe deponohen në llogarinë e komunës. Një zgjidhje e përshtatshme duhet të prezentohet deri në fund të vitit 2015.</p>		<p>Pjesërisht Ka pasur përpjekje për përmirësimin e inkasimit të të hyrave komunale. Ndersa bartja e të hyrave vetëm sa ishte rritur nga viti i kaluar.</p>	

Shpenzimet përmes prokurimit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të prokurimit gjatë vlerësimit të tenderëve dhe pranimit të punëve dhe furnizimeve për të siguruar që pagesat e bëra janë vetëm për punët/furnizimet e pranuar që plotësojnë kërkesat e cilësisë. Asnjë kontratë nuk duhet t'i ofrohet operatorëve që nuk plotësojnë kriteret e tenderit. Në anën tjetër, të gjitha shpenzimet që kërkojnë prokurim duhet të kalojnë përmes procedurave adekuate të prokurimit për të siguruar vlerën për para. Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi i nevojave bëhet bazuar në analiza adekuate për të shmangur tejkalimet e shpenzimeve të planifikuara.		Pjesërisht Kryetari kishte formuar një ekipe profesionistësh të cilët merren me vlerësimin dhe kontrollin e punëve. Gjatë vitit 2015 janë ëparaqitur shume mangësi lidhur me kete fushe.	
Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari i Komunës duhet ta rishqyrtojë arsyeshmërinë e praktikave të hyrjes në kontrata dhe kryerjes së pagesave paraprake shumë kohë para fillimit të projektit. Për më tepër, marrëveshjet duhet të sigurojnë raportim adekuat të financave dhe rezultateve gjatë fazës së implementimit për të krijuar një bazë për monitorim. Raportet finale duhet të publikohet për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.		Pjesërisht Ne nuk kemi hasur ne pagesa para fillimit te projekteve. Raportimet kishin munguar ne rastet e marrëveshjeve per bashkëfinancim te projekteve.	
Paga dhe mëditje	Kryetari i Komunës duhet t'i analizojë shkaqet pse nuk janë respektuar procedurat e rekrutimit në rastet e identifikuar dhe të sigurojë që këto do të mbeten raste të izoluar. Kontrolllet gjatë rekrutimit duhet të forcohen dhe procesi duhet të monitorohet nga Kryetari për të siguruar që pranohen vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e parapara.			Jo nuk eshte implementuar. Mangesi ishin vërejtur gjate auditimit te rekrutimeve gjate vitit 2015.

	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë rishikimin e vendimit për emërim të drejtorit të QKMF-së dhe të sigurojë që të gjitha rekrutimet bëhen në pajtim të plotë me kërkesat ligjore. Kontrollat lidhur me pagesën e stafit arsimor duhet të forcohet për të siguruar që të gjitha pagesat janë të mbështetura me dëshmi të mjaftueshme në përputhje me rregullat financiare.</p>	<p>Po Gjate procesit të rekrutimit të drejtorit të QKMF-së është zhvilluar një proces rekrutues dhe është bere perzgjedhja e drejtorit.</p>		
Subvencione dhe Transfere	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim për ndarjen e subvencioneve dhe t'i forcojë ato për të siguruar që të gjitha shpenzimet për subvencione janë në pajtim me rregulloren e brendshme dhe kontribojnë në arritjen e objektivave të komunës. Të gjithë përfituesit duhet të bëjnë raportime kthyesë në komunë për të siguruar vlerën për paranë dhe për të shmangur mundësinë e mashtrimeve. Kryetari duhet të sigurojë se rastet e mundshme të konfliktit të interesit do të shmangen dhe nuk do të përsëriten në të ardhmen.</p>		<p>Pjesërisht komuna ka draftuar rregulloren e re derisa sa i përket monitorimit të subvencioneve, ende ka lëndë që nuk kanë adresuar këtë. Poashtu janë hasur parregullsi në kategorinë e subvebncioneve gjate auditimit 2015.</p>	
Pasuritë	<p>Të sigurohet një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive, duke përcaktuar rolet kyçe që në këtë proces mund të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke mbledhur dhe raportuar të gjitha të dhënat mbi pronat në posedim të komunës. Më pas, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim të pasurive të identifikuar dhe, pas rishikimit kritik nga ana e Kryetarit, një raport t'i dorëzohet zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Gjithashtu, komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohen çdo vit në kohë adekuate që</p>			<p>Jo Pasuritë e trashëguara nuk janë regjistruar, poashtu nuk janë regjistruar as blerjet.</p>

	të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar.			
Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të iniciojë analizimin e arsyeve të nivelit të lartë të të arkëtueshmeve dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të prezantohen për të mundësuar mbledhjen e të arkëtueshmeve historike, përfshirë edhe veprimet ligjore.		Pjesërisht Jane ndermarre hapa per inkasimin e borxheve dhe per menaxhimn e te hyrave. Mangesi janë vërejtur edhe gjate vitit 2015.	
Obligimet	Kryetari i Komunës duhet t'i forcojë kontrollet menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Për trajtimin e borxheve të akumuluar, Kryetari duhet të paraqes një plan ku parashihen veprime konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të komunës. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i komunës.		Pjesërisht ZKF nuk verifikon deklaratat e udhëheqësve të njësive me rastin e identifikimit të faturave të papaguara.	
Auditimi i brendshëm	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që KA merr një rol pro-aktiv në mënyrë që të arrihet përfitimi maksimal nga sistemi i auditimit të brendshëm. KA duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e NjAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës. Kryetari duhet të vendosë komunikim të rregullt me NjAB-në për të parandaluar gabimet dhe parregullsitë në sistemet financiare dhe operative të komunës.			Niveli i implementimit te rekomandimeve është ende i vogël. Komiteti i Auditimit nuk kishte qene mjaft funksional gjate vitit 2015.